

**BASHKIA E TIRANËS**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Drejtuar: Operatorit ekonomik “Fusha” shpk**

**Adresa: Njësia Bashkiake Nr. 2, rruga “Murat Toptani”, godina Nr. 25, Tiranë**

**Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e II-të”**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e II-të”.**

**Fondi limit: 979,884,648.56** (nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e dyzetë e tetë pikë pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve me Vendimin Nr. 45, datë 19.09.2016 “Për shpërndarjen e financimit për projekte, Thirrja III e Grantit “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale”, Programi “Zhvillimi i Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale”, Shtylla I, për vitin 2016” si dhe nga buxheti i Bashkisë së Tiranës, miratuar me VKB Nr. 75, datë 07.10.2016 “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr. 58 datë 30.12.2015 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” (i ndryshuar)”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 27.12.2016, ora 09:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 49 datë 12.12.2016.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët ☒ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “Fusha” shpk**

NUIS J61922018S

Vlera e ofertës = **978,878,878.78** (nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**

**Nuk ka asnjë Operator ekonomik të skualifikuar**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Fusha” shpk**, me adresë: **Njësia Bashkiake Nr. 2, rruga “Murat Toptani”, godina Nr. 25, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **978,878,878.78** (nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitörja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë:** 28.12.2016

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të

Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.